



Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” Shpk & “Alko Impex General Konstruksion” dshh shpk

Adresa: Tiranë, Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë Nyjes së Betonit

Adresa: Rr. “Reshit Petrela”, kompleksi Usluga, prane stacionit te trenit, Tirane

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

- 1. Procedura e prokurimit: “Rehabilitimi i fasadës së pallatit te kryqezimi i rrugës së Dibrës me Unazën e Vogël”**
- 2. Nr. References, REF-17101 – 04 - 08-2019**
- 3. Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është **“Rehabilitimi i fasadës së pallatit te kryqezimi i rrugës së Dibrës me Unazën e Vogël”**, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.
- 4. Fondi limit: 26.265.709 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjete e pesë mijë e shtatëqind e nëntë) lekë pa TVSH.**
- 5. Burimi i financimit:** Burimi i Financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB nr.159 datë 21.12.2018, per ‘Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019-2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.
- 6. Kohëzgjatja e kontratës:** 4 (katër) muaj nga momenti i lidhjes së kontratës.
- 7. Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29.05.2019 , Ora: 11:00**
- 8. Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 15 datë 15.04.2019.**
- 9. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X**
oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk

NUIS K67106202W

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **0 (zero) lekë**

2. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Bajrami N”shpk & “Meteo”shpk

NUIS K02727202O & L26310801C

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **19,672,434.4** (nëntëmbëdhjete milion e gjashtëqind e shtatëdhjete e dy mijë e katërqind e tridhjetë e katër presje katër) lekë.

3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B-93”shpk & “Avduli”shpk

NUIS J62903508R & NUIS J66703306O

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **20,769,076** (njëzet milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë gjashtë) lekë.

4. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk

NUIS L66926804L

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **21,858,712** (njëzet e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dymbëdhjete) lekë.

5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Everest”shpk & “Klajger Konstruksion”Shpk & “Alko Impex General Konstruksion” dshh shpk

NUIS J78311921L & K51423028P & K91326028I

Çmimi total i ofertës pa tvsh= **23,384,498** (njëzet e tre milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë.

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euro Alb” shpk

NUIS K51501008J & K66613407H

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **24,444,444** (njëzet e katër milion e katërqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë.

Janë skualifikuar Operatorët Ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk , me NUIS K67106202 E

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ELDA-VL” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë,** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2 Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Bajrami N”shpk & “Meteo”shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Bajrami N” shpk & “Meteo”shpk, nuk plotësojnë pikën 3 dhe 3.1 për Kapacitetin ekonomik dhe financiar të DST, pasi OE “Bajrami N”shpk, nuk ka paraqitur në SPE, vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019.

OE “Meteo”shpk, nuk ka paraqitur në SPE, vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Bajrami N”shpk & “Meteo”shpk, e kanë patur detyrim të paraqisnin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, deri në datën e zhvillimit të tenderit, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë

20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B-93”shpk & “Avduli”shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

-Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B-93”shpk & “Avduli”shpk nuk plotësojnë pikën 15 të Kapacitetit Teknik të DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”*, pasi BOE ka deklaruar (1) Autovinc me targa FR 9664 C ku pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se nuk disponon certifikate për transport mallrash.

-Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B-93”shpk & “Avduli”shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10), pika a, pasi Autobetonieret e vena në dispozicion nga OE B-93, janë të parregullta. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin lidhur me këto mjete por nuk ka paraqitur certifikatë të rregullt për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit lidhur me këtë mjetet. Certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik lidhur me mjetet është certifikatë ku citohet “VETEM PER LLOGARI TE VET” pra të qeradhënësit, sa më sipër paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin do të konsiderohet e paplotë për rrjedhojë e pasaktë.*

-Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “B-93”shpk & “Avduli”shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10), pika a), pasi OE “B-93” shpk, ka paraqitur Autopompë betoni Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin lidhur me këtë mjet, por nuk ka paraqitur certifikatë të rregullt për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit. Certifikata e paraqitura nga operatori ekonomik lidhur me mjetin është certifikatë ku citohet “VETEM PER LLOGARI TE VET” pra të qeradhënësit, sa më sipër paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin, do të konsiderohet e paplotë për rrjedhojë e pasaktë.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

-Operatori Ekonomik “**INERTI**” shpk, nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10), pika a), pasi OE “INERTI” shpk, ka paraqitur mjetin, Autobot uji. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin lidhur me këtë mjet, por nuk ka paraqitur çertifikatë të rregullt për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit. Çertifikata e paraqitura nga operatori ekonomik lidhur me mjetin është çertifikatë ku citohet “VETEM PER LLOGARI TE VET” pra të qeradhënësit, sa më sipër paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin, do të konsiderohet e paplotë për rrjedhojë e pasaktë.*

-Operatori Ekonomik “**INERTI**” shpk, nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit, *pasi OE “INERTI” shpk, ka paraqitur mjetin, Kamioncinë me dokumentacionin pwrkatws pwr këtë mjet, por nuk ka paraqitur çertifikatë të rregullt për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit. Çertifikata e paraqitura nga operatori ekonomik lidhur me mjetin është çertifikatë ku citohet “VETEM PER LLOGARI TE VET” pra të qeradhënësit, sa më sipër paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin, do të konsiderohet e paplotë për rrjedhojë e pasaktë.* Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamiona, kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 7 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur vetëm një kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit.

Operatori Ekonomik “**INERTI**” shpk, nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10), Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës **minimum 10 (dhjete) ton dhe maksimumi 15 (pesembedhjete) ton per secilin kamion (gjithsej 2 copë).** OE ka paqitur në SPE dy kamiona. Asnjë nga kamionët e paraqitur nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit, për Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës **minimum 10 (dhjete) ton dhe maksimumi 15 (pesembedhjete) ton per secilin kamion (gjithsej 2 copë).***

Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit. OE pjesëmarrës në këtë procedurë me anë të një deklarate të paqitur në SPE, pranon se tonazhi i dy mjeteve të paraqitura, nuk janë sipas kërkesave të DST.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euro Alb” shpk NUIS K01725001F & NUIS K31329048I

Përkatësisht për arsytet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euro Alb” shpk, nuk plotësojnë pikën 2 të DST.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euro Alb” shpk, ka paraqitur në SPE kontratën për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive nr.3904 rep dhe 2735 kol datë 29.05.2019. Në nenin 4, “Pjesëmarrja”, ndër të tjera thuhet: --Shoqëria "EURO-ALB" shpk, dote kontribuojë në masën 6.77 % në këtë pjesëmarrje duke marrë persiper të realizojë këtë zëra punimesh : A-1 punime prishje dhe montimi dhe ngritje kantieri (të gjithë zërat e punimeve që përfshihen nën të).

Shoqëria "Sireta 2F" shpk do të kontribuojë në masën 64.79 % në këtë pjesëmarrje duke marrë persiper të realizojë sipas preventivit, me indeksat përkatës, të gjitha zërat e tjera të punimeve.

Shuma Totale e realizimit të punëve, sipas përqindjes është 71.56 % (shtatëdhjetë e një pjesë pesëdhjetë e gjashtë përqind)

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, nuk është bërë sipas përcaktimit ligjor të parashikuar në Kren VIII Nenit 74 pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar)

Në kontratën për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive nr.3904 rep dhe 2735 kol datë 29.05.2019, nuk është përcaktuar pjesa e plotë prej 100% për realizimin e punëve, cka e bën të pavlefshme kontratën për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kren VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Everest” shpk & “Klajger Konstruksion” Shpk & “Alko Impex General Konstruksion” dshh shpk kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **23,384,498** (njëzet e tre milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **29,512,197** (njëzet e nëntë milion e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë.**

Afati kohor për kryerjen e punimeve është brenda 4 (katër) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.06.2019**

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk ka patur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë **“Everest” shpk & “Klajger Konstruktion”Shpk & “Alko Impex General Konstruktion” dshh shpk**, me NUIS J78311921L & K51423028P & K91326028I, me Adrese Tiranë, Kamëz, Fabrika në Rrugën Nacionale, pranë Nyjes së Betonit, *se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa tvsh = 23.384.498* (njëzet e tre milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë, *është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.